

PAL SOKOLI

ROBI I LIRISË.. NËN TINGUJT E NATËS.. GJETI.. RRUGËN E LIRISË.. DERI TË GJEOGRAFIA.. E PLOTË

Dibran Demaku "Gjeografia e klasës sime", Alma Papamihali "Nën Tingujt e Natës" dhe Hasan Qyqalla "Robi i Lirisë" u promovuan në Koblenz-Raental-Gjermani

Në kuadrin e aktiviteteve kulturore, për nder të pavarësisë së Kosovës dhe në saj të zhvillimeve më të reja, nga kultura dhe letërsia shqiptare në Gjermani, me organizimin e Lidhjes së Shkrimtareve, artistëve dhe krijuesve shqiptarë në Gjermani (LSHAKSH) dhe të Sh.I.H.K " Stublla " (Shoqata Integruese Humanitare dhe Kulturore Stublla), me 26.04.08, në Koblenz-Raental në rrugë St.Elisabeth str.8 ,duke filluar nga ora 12,00, u mbajt Orë e madhe Letrare, ku dashamirësit e artit dhe të letërsisë, patën rastin të përcjellin një festë kulturore. Salla e dekoruar më flamujt tanë kombëtare dhe shtetërorë dhe me pikturat me tematikë lirike dhe kombëtare të piktorit dhe aktivistit Asllan Dibrani në njërën anë, si dhe të foto-eksponitës me titull "Rruga e lirisë" të shkrimtarit dhe luftëtarit, qe është edhe kryetari i LSHAKSH-në Gjermani, zotit Martin Çuni, kryesisht me temë nga lufta e fundit në Kosovë, në anën tjetër, ishte krijuar atmosferë e dëshirueshme për promovimin e librave të rinj nga poetet tanë.



Anëtarë të LSHAKSH-në Gjermani dhe aktivist të tjerë

Në praninë e qindra dashamirësve të fjalës së shkruar, tubimin e hapi Muhamet Nikçi, i cili pasi përshëndeti të pranishmit, i dha fjalën z. Martin Çuni i cili përshëndeti të pranishmit në emër të LSHAKSH-në Gjermani dhe ju uroj suksese poetëve që promovonin librat e tyre me Kosovë të Lirë, dhe i falenderoi edhe Sh.I.H.K " Stublla ", të cilët po luajnë një rol të rëndësishëm, në integrimin ndërshqiptar dhe me institucionet gjermane.



Hasan Qyqalla, Alma Papamihali dhe Dibran Demaku-figurat kryesore të takimit

Pastaj z. Nikollë Gjoni, në emër të SHHK "Stublla", uroi që të ketë gjithmonë promovime të tilla, dhe se shoqata e tyre është e gatshme të bashkëpunojë dhe të ndihmojë gjithnjë promovime të tilla. Përballë publikut në Tryezën e nderit ishin autorët e mbrëmjes, z. Dibran Demaku, zj. Alma Papamihali dhe z. Hasan Qyqalla.



Për librin me poezi për fëmijë “Gjeografia e klasës sime” të z. Demaku, foli Hasan Qyqalla. Z. Qyqalla, recitoi disa poezi dhe i komentoi vlerat artistike dhe stilin e profiluar tanimë të poetit Demaku në këtë libër poetik, i cili është aq i nevojshëm për gjeneratat e reja, që po rriten në mërgatën shqiptare këtu në Gjermani. Për Librin poetik të Alma Papamihalit “Nën Tingujt e Natës”, foli z. Pal Sokoli.



Pal Sokoli referoi për dy librat e rinj

Pal Sokoli foli për rëndësinë e këtij vëllimi poetik (prej 100 poezish), për letërsinë tonë shqiptare dhe freskinë që i solli Alma me stilin e saj të veçantë, plot mesazh dhe që mbërthen tema të larmishme nga gjeni ynë dhe fati i tij, nga jeta jonë në atdhe, në mërgim dhe fundi i kësaj buqete poetike, lirika e saj për dashurinë.”Alma komunikon me realitetin dhe urren rastësinë, determinizmin, përgjumjen, kacavjerrjet. Ajo është për atë, që të merren përgjegjësi për t’ a lëvizur jetën përpara”. Duke përjetuar peshën e mërgimit, Alma i kushton disa poezi mërgatës,”Për mërgimtarët të gjitha stinët janë dimër, por Alma në këtë libër poetik, zbulon një stinë të re, stinën e Dashurisë. Ajo e ngroh dhe e përcjell kudo që shkon. Ajo është dashuria ndaj Atdheut dhe njerëzve të saj”, tha P. Sokoli duke i dëshiruar zj. Alma Papamihali, suksese të reja në krijimtari.

Pastaj i erdhi radha, përmbledhjes poetike të H.Qyqallës, “Robi i Lirisë”, për të cilin foli gjithashtu krijuesi P. Sokoli. Librin e dytë të z. Qyqalla, Pali e quajti më tepër se përmallim poetik, ndersa në librin”Dua të vdes shqip” z. Qyqalla, kishte përmallim poetik. Tani ky përmallim ka shkuar më larg, poeti është bërë më i ndjeshëm. Tanimë metafora “Loti”apo realiteti Loti, fuqizohet në poetiken poetit dhe e gjën atë në mes dy thikash-Rob i lirisë. Poeti komunikon me figurat më të ndritshme të kombit për fatin e vet, fatin e Kosovës dhe veten e shëh të struktur në perëndim, me lot në sy. Lotët e poetit rrjedhin nga dy syte, njeri i

pikon në Atdhe e tjetri në mërgim, por qe të dy rrjedhin për të njëjtin qellim”, tha ndër të tjera P. Sokoli.



Martin Çuni, Alma Papamihali dhe Nikollë Gjoni

Publiku priti me vëmendje të veçantë këta libra të rinj të krijuesve tanë. Pastaj pati edhe diskutime tjera rreth këtyre librave, recitime nga këto përmbledhje nga vet autorët, qe u mirëpritën nga publiku i pranishëm artdashës. Të pranishmit, në emër të “Unionit artistik shqiptar” i përshëndeti Can Tahiri, pastaj Qerim Shkreli në emër të Forumit shqiptarë për kulturë dhe sport në gjermani” Arbëria” nga Pforzhaeim, të cilët ju dhuruan disa aktivistëve mirënjohje e sidomos bashkëudhëtarve të Karvanit të pavarësisë. Asllan Dibrani ju dhuroi disa aktivistëve dhe krijuesve imazhe të kopjuara nga figurat tona kombëtare të pikturuara nga dora e tij. Poezi me pasion lexuan edhe poetet dhe krijuesit e pranishëm si Sadik Krasniqi, Sevëme Preteni, Avni Alia dhe befasi më sublime e kësaj mbrëmje poetike Valon Shkreli (i biri i poetit tonë të madh, tanimë të ndjerë Azem Shkrelit), i cili emocionoi të pranishmit me poezinë “Katër këshilla vetës” nga Azem Shkreli. Të pranishëm ishin edhe dr. Gjermal Mustafa, Shani Sejdiu, Sadri Gashi, Fehmi Sopi. Rifat Binaku dhe Ish futbollisti i Prishtinës Ramadan Mehana.



Sarë Xhaferi(mbesa e Almes) pjesëmarrësja më e re ne intervistë me poetin dhe gazetarin Dibran Demaku

Me një valle artistike, të cilën me mjeshtri e udhëhoqi Qerim Shkreli, u mbyll kjo mbrëmje e bukur kulturore. Po shihet se kohët e fundit, po rritët dukshëm interesimi për takime të tilla. Pjesa tjetër kaloi në takime dhe njohje të reja të krijuesve ndërmjet njëri tjetrit, rreth djaloshëve të Stubllës që na pritnin e përcillnin me admirim, dhënie autogramesh dhe shpërndarje librash te autoreve te pranishëm. U shpreh dëshira, që takime të tilla me krijuesit tanë, të organizohen sa më shpesh.